



RRUGËS SË DIJES ME PARIME DEMOKRATIKE



BARAZIA MBI TË GJITHA

RION (11), ERION (11), OLT (12), ERZA (12), ERTI (11), ELITA (11), ATIONA (11)



Barazia është vlerë e demokracisë. Por, përveç këtij elementi, në demokraci bëjnë pjesë edhe elemente të tjera shumë të rëndësishme. Ato do t'i mësoni nga ne, përmes këtij artikulli

Vetë kuptimi i fjalës demokraci do të thotë udhëheqje e popullit. Kjo nënkupton se mundësinë për të udhëhequr e kanë të gjithë, e jo vetëm një person ose një familje e caktuar. Pikërisht kjo barazi e qytetarëve fuqizon dhe i jep vlerë sistemit demokratik të qeverisjes. Përveç barazisë, elemente të tjera të demokracisë janë: paqja, liria, respekti, solidariteti, toleranca, etj. Me zbatimin e këtyre elementeve, rriten gjasat edhe më shumë që shteti ynë të zhvillohet edhe më tutje. Parimet apo elementet e demokracisë i zbatojmë edhe ne në ambientet ku jetojmë. Për shembull, ne kemi përdorur procesin e votimit për të zgjedhur kryetarin e klasës. Këtë e kemi bërë duke e ditur se përmes votave tona, mund të shprehim mendimet tona lirshëm. Ne gjithashtu mund të kandidojmë për t'u zgjedhur vetë udhëheqës të klasës. Kjo do të thotë se për sa i përket vendimmarrjes, ne trajtohem të gjithë në mënyrë të barabartë.

Mesazhi më i mirë që sot morëm nga Punëtorja më e madhe e Demokracisë „Demos-ti“, është se ne jemi ata të cilët mund të ndikojmë në zhvillimin e nivelit demokratik. Këtë ndikim mund ta arrijmë duke u treguar qytetarë aktiv dhe shumë të përgjegjshëm. Kjo do të thotë se në çfarëdo situatë që jemi, duhet të



Barazia dhe liria mbushin zemrat tona me lumturi

veprojmë në bazë të vlerave demokratike. Ju ftojmë të gjithëve të mundohemi të mos bëjmë dallime për nga gjinia, raca, kombi, feje, etj. Ne duhet t'i respektojmë të gjithë dhe ta pranojmë njëri-tjetrin ashtu siç jemi dhe pa kushte.

Le të jetë zhvillimi i shtetit tonë synimi kryesor i qytetarëve demokratik. Ne jemi ata të cilët mundemi dhe me përkushtim do t'ia dalim të jemi edhe më të mirë.



Të vegjël, por shumë demokratikë

AKTIVIZIMI I POPULLIT

LEA (11), EDITA (11), MELVIS (11), GENTRIT (11), OLIS (12), ARTA (11), GABRIEL (11)



Me qytetari aktive kuptojmë veprimet e qytetarëve në përpjekje për përmirësimin e vendit. Të tillë jemi edhe ne shpeshherë. Se si e bëjmë këtë vazhdoni të lexoni artikullin në vijim

Qytetaria aktive ndihmon zhvillimin e shtetit dhe të demokracisë. Veprimet që qytetarët aktiv i bëjnë lidhen me: pjesëmarrjen e tyre aktive në zgjedhjet shtetërore, ndihmën ndaj personave të tjerë, punën vullnetare, marrjen e iniciativave pozitive për të gjithë, hapjen dhe angazhimin në OJQ, marrjen e veprimtarive të tjera, të cilat lidhen me mbrojtjen e ambientit, etj.


Rastin që të jemi qytetarë aktiv e kemi pasur edhe ne edhe pse të vegjël në moshë. Në grupin tonë të diskutimit i kemi përmendur disa raste, përmes të cilave dëshirojmë t'iu tregojmë të tjerëve se si është të jesh qytetar aktiv.

Disa prej veprimeve, të cilat i kemi bërë më herët dhe që hyjnë në radhën e qytetarisë aktive janë: mbrojtja

e kafshëve në rrezik, pastrimi i ambientit në klasën tonë, shpërndarja e veshmbathjeve për fëmijët në nevojë, shpërndarja e ushqimeve dhe parave gjatë Ditës së Falenderimeve në të gjitha jetimoret dhe marrja e iniciativave të ndryshme për të gjithë qytetarët. Tërë këto iniciativa i kemi bërë nga vullneti ynë i madh për t'i ndihmuar shtetit dhe bashkëqytetarëve tanë.

Një gjë të rëndësishme që e bëjnë qytetarët aktiv është pjesëmarrja në procesin më të rëndësishëm shtetëror, i njohur si proces zgjedhor. Përmes këtij procesi, qytetarët aktiv vendosin se cilët janë personat më të denjë për ta përfaqësuar dhe qeverisur shtetin.

Votat e tyre përcaktojnë të ardhmen e popullit. Andaj, shteti përfiton vetëm përmes qytetarëve aktiv, të cilët ndjejnë përgjegjësi të madhe për shtetin e tyre. Ne do të vazhdojmë të kontribuojmë duke dhuruar dhe duke vazhduar që të jemi qytetarë aktiv. Mirëpo, na duhet edhe ndihma juaj. Ejani dhe bashkohuni me ne.



Qytetarët aktiv votojnë, sepse e dijnë rëndësinë e votës



Fytyrat e buzëqeshura të disa qytetarëve aktiv

ZGJEDHJA ËSHTË PJESË E JETËS SONË

ARTINA (11), ANDETA (12), OLTA (12), ARSIM (12), ERAJ (12), RINEA (11), ERION (12), RELA (12),
ARDIT (12), ERDETA (11), FAZLI (11)



Të kesh mundësi të zgjedhësh është shumë e rëndësishme në vendin tonë. Ne sot mësuam edhe për procesin zgjedhor dhe zgjedhjet e përditshme

Ne jemi shumë të lumtur që në demokraci kemi të drejtë të zgjedhim udhëheqësit tanë. Mirëpo, edhe ne si fëmijë zgjedhim. Sot edukatorja jonë na pyeti se çfarë sporti na pëlqen dhe ne treguam se kemi të dëshirë të luajmë sporte të ndryshme. Për sportin më të pëlqyer, ne sot votuam. Edhe pse kjo nuk ishte hera e parë që votuam për aktivitete.

Megjithatë, për të marrë pjesë në procesin zgjedhor shtetëror duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Kjo sepse zgjedhjet janë procesi më i rëndësishëm demokratik. Zgjedhjet duhet të ndodhin çdo 4 vjet. Kjo nënkupton se mandati i udhëheqësve tanë është 4 vjet. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet lokale dhe ato qendrore. Në zgjedhjet lokale zgjedhet kryetari i komunës dhe asamblistët. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore zgjedhen deputetët. Faleminderit për vëmendjen tuaj.



Kur të arrij moshën e duhur, mund të blej edhe një veturë



Unë zgjedh atë që mua më pëlqen më së shumti



Autorët punëtorë dhe gazetarë

RËNDËSIA E KUVENDIT TEK NE, NXËNËSIT

ENEA (11), LIS (11), EDION (11), JON (11), ENSAR (11), LEONA (12), ERIS (11), DJELLZA (11), DEA (11),
RRON (11), ARBA (11)



E drejta e arsimit është një ndër të drejtat me vlerë shumë të madhe. Kjo e drejtë është fryt i „Shtëpisë së Popullit“

Të dashur lexues, ju jeni shumë me fat. Sot nga grupi ynë „Idealët“ do të keni mundësi të merrni shumë informata që kanë të bëjnë kryesisht me demokracinë. Gjithashtu, me shumë kënaqësi do t'iu tregojmë edhe për Kuvendin

Demokracia është sistem, në të cilin të gjithë qytetarët trajtohen në mënyrë të barabartë. Për këtë, unë Leona nuk gëzoj asnjë të drejtë më shumë sesa shokët e mi. Në këtë mënyrë, funksionojnë edhe institucionet e vendit tim. Për shembull, deputetët edhe pse punojnë në Kuvend, nuk janë më të privilegjuar sesa ministrat të cilët punojnë në Qeveri. Parimisht, të gjithë jemi njerëz dhe asnjëri nuk ka lindur me më shumë të drejta.

Unë dhe Dea jemi shoqe shumë të mira, mirëpo Dea është paksa më e përgjegjshme dhe më aktive sesa unë. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që unë jam e diskriminuar dhe që Dea gëzon më shumë të drejta se unë. Nga kjo kuptojmë që të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta, por janë vetë qytetarët ata të cilët vendosin cilën të drejtë dëshirojnë ta shfrytëzojnë.

Sa e sa herë, brenda artikullit e kemi përmendur trajtimin në mënyrë të barabartë. Por, cili institucion na mundëson dhe punon që të ketë sa më shumë barazi, iu tregojmë në vazhdim të artikullit.

Është Kuvendi ky institucion, i cili merret me miratimin e ligjeve. Ligje të cilat jetës sonë i japin më shumë ngjyrë. Në Kuvend punojnë 120 deputetë, të cilët janë zgjedhur me vota të lira të popullit. Pa dyshim, kur themi popull nënkuptojmë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare. Pra, deputetët zgjedhen nga qytetarët dhe e

kanë për obligim që t'i përfaqësojnë pikërisht ata. Ky është edhe një ndër tri funksionet e Kuvendit, funksioni përfaqësues.

Dy funksionet e tjera janë: funksioni legjislativ dhe ai kontrollues. Thuhet funksion legjislativ, sepse i miraton ligjet, të cilat zbatohen nga ne. Kurse, funksioni kontrollues përshkruan detyrën e Kuvendit për të kontrolluar punën e Qeverisë.

Kaq për sa iu përket fakteve rreth Kuvendit. Ne kemi dëshirë të tregojmë edhe disa mendime tona për Kuvendin dhe disa kërkesa. Ne jemi në klasën e VI-të dhe kurrikula e re mësimore ka sjellur paksa ndryshime tek mënyra e të të mësuarit. Kurrikula është shumë e mirë, sepse kërkon nga ne si nxënës më shumë angazhim, por ka diçka që nuk po në përshtatet edhe aq. Këto janë ndryshimet e shumta në librat shkollorë.

Në shkollën tonë në lëndën e biologjisë ne mësojmë me librin e klasës së VIII-të, edhe pse jemi ende në klasën e VI-të. Kjo nuk është shumë e mirë për ne, sepse ne nuk jemi të njohur ende me disa gjëra që janë të parapara për klasën e VI-të, si për shembull ndërtimi i qelizës. Kjo është diçka që ne do të kërkonim nga Kuvendi që të bëjë ndonjë ndryshim.

Ndërsa, për punët e tjera të këtij institucioni jemi më se të kënaqur. Shpresojmë që gjërat e cekura këtu do t'iu mbesin gjatë në mendje.



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Elena Gjika“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë